



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 23.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AMENDAMENTIN E KIGALIT, TË PROTOKOLLIT TË MONTREALIT, “PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHITESËN E OZONIT””

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit, të Protokollit të Montrealit, “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit” , në mbledhjen e datës 23 nëntor 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

- **Protokolli i Montrealit**

Protokolli i Montrealit u hartua për të reduktuar prodhimin dhe konsumin e substancave që hollojnë shtresën e ozonit me qëllim reduktimin e tyre në atmosferë duke mbrojtur kështu shtresën e brishtë të ozonit. Protokolli është miratuar në shtator 1987 dhe ka hyrë në fuqi në janar 1989.

Ky Protokoll është ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr.8463, datë 3.10.1999 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Vjenës "Për mbrojtjen e shtresës së ozonit" dhe Protokollin e Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit". Ai është amenduar 5 herë deri tani (Amendamenti i Londrës; Kopenhagenit; Montrealit; Pekinit dhe së fundmi i Kigalit) dhe Shqipëria ka aderuar në vitin 2006 në të katër amendamentet e para.

- **Qëllimi i projektligjit**

Projektligji ka si qëllim aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit, të Protokollit të Montrealit, “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

Shqipëria, si pjesë e komunitetit të Protokollit të Montrealit, ka detyrimin të përputhë kuadrin e saj ligjor me atë të Bashkimit Evropian dhe vendeve të tjera të globit, sipas përcaktimeve të amendamenteve të Protokollit të Montrealit për lëndët ozonholluese.

Nëpërmjet Amendamentit të Kigalit, komuniteti i Protokollit të Montrealit, pjesë e të cilit është edhe Shqipëria, merr përsipër përgjegjësinë për HFC-të që kontribuojnë në qëllimet e qëndrueshmërisë, në përputhje me agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Amendamenti i Kigalit është një tjetër angazhim global për të ndaluar ndryshimin e klimës. Delegatët në Kigal, punuan shumë për të negociuar dhe arritur një marrëveshje që do i mandatonte palët të ulnin prodhimin dhe përdorimin e Hidrofluorkarbonit (HFCs). HFC-të janë kimikate të krijuara nga njeriu që përoren kryesisht në frigoriferë, kondicionerë dhe izolimet me shkumë, dhe janë gaze me efekt serrë të fuqishëm që mund të jenë me shumë herë më të fuqishëm se dioksidi i karbonit përsa i takon kontributit negativ në ndryshimet e klimës.

Ky amendament sanksionon përdorimin në mënyrë efektive të substancave me potencial të ulët ose zero të ngrohjes globale, si dhe përdorimin e substancave që nuk dëmtojnë shtresën e ozonit.

Me hyrjen në fuqi të Amendamentit të Kigalit, sipas përcaktimeve të nenit 4, të këtij Amendamenti, kufizohet tregtia e HFC-ve ndërmjet shteteve palë dhe jopalëve, duke paragjykuar pozitat e shteteve jo palë. Amendamenti nuk eliminon tërësisht HFC-të, por parashikon kontrollin e substancave të listuara për shkak të ndikimit të tyre në atmosferë.

Ky amendament do të hyjë në fuqi në 1 janar 2019. Por çdo Palë që nuk është në gjendje të vendosë dhe zbatojë këtë sistem nga data 1 janar 2019, mund të vonojë ndërmarrjen e këtyre veprimeve deri më 1 janar 2021.

- **Pritshmëritë nga zbatimi i amendamentit të Kigalit**

Amendamenti i Kigalit pritet të parandalojë ngrohjen deri në 0.5 ° celcius deri në fund të shekullit, duke dhënë, kështu, një kontribut pozitiv në arritjen e objektivave të Marrëveshjes së Parisit.

Ekspertët mjedisorë theksojnë se amendamenti i Kigalit mund të jetë kontribuesi real i vetëm më i madh që bota ka bërë deri tani drejt mbatjes së rritjes së temperaturës globale nën 2 gradë celcius, një objektiv i vendosur në Paris në konferencën për klimën.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk morën pjesë në mbledhje.

Besnik BARAJ

Relator

Eduard SHALSI

Kryetar